



RAPORTI VJETOR **2025**

keptrust.org





* Me përjashtim të pasqyrave financiare, raporti vjetor nuk është audituar nga auditori i pavarur.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive	1
Misioni	2
Profil i Institucionit	3
Struktura Organizative	4-5
Mesazhi i Kryetarit të Bordit të Drejtorëve	6-7
Mesazhi i kryeshefit ekzekutiv	8-9
Përmbledhje e tregut dhe pozicionimi strategjik	10-11
Zhvillimi i biznesit	12-15
Komunikimi i marketingut	16
Shërbimi ndaj klientëve	17
Transformimi digjital	18
Performanca financiare	19-21
Menaxhimi i rrezikut	22-26
Auditimi i brendshëm	27
Departamenti juridik/ligjor dhe pajtueshmëria	28-29
Organizimi dhe menaxhimi i proceseve – Qeverisja mjedisore dhe sociale (QMS)	30-31
Teknologjia e informacionit	32
Burimet njerëzore	33
Përgjegjësia sociale	34-35
Perspektiva dhe prioritetet për 2026	36-37
Raporti i auditorit të pavarur	38

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor 2025 paraqet zhvillimet kryesore të KEP Trust gjatë vitit në fushën e aktivitetit kreditues, performancës financiare, menaxhimit të rrezikut, transformimit digjital, përvojës së klientit, zhvillimit organizativ dhe përgjegjësisë sociale.

Gjatë vitit, institucioni operoi në një mjedis ekonomik të karakterizuar nga një stabilitet relativ, por edhe nga sfida që lidhen me inflacionin, luhatjet në tregjet financiare dhe ndryshimet e vazhdueshme në nevojat e klientëve. Në këtë kontekst, fokusi mbeti në ruajtjen e stabilitetit operacional, përmirësimin e proceseve të brendshme dhe ofrimin e shërbimeve kreditore efikase dhe të qasshme.

Aktivitetet e zhvillimit të biznesit u orientuan drejt zgjerimit të shërbimeve në segmentet prioritare dhe përmirësimin të ofertës për klientët ekzistues dhe potencialë. Paralelisht, u vazhdua me iniciativa për optimizimin e proceseve operative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në të gjitha nivelet e institucionit.

Po ashtu, u shënuan avancime të mëtejshme në fushën e teknologjisë dhe transformimit digjital. Investimet në sisteme, automatizim, siguri të informacionit dhe mjete të reja teknologjike mbështetën rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e qasjes në informata dhe shërbime për klientët dhe stafin.

Përmes monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve, analizimit të nevojave të klientëve dhe përmirësimin të komunikimit, institucioni vazhdoi të forcojë marrëdhëniet me klientët dhe të avancojë standardet e shërbimit.

Njëkohësisht, menaxhimi i rrezikut, auditimi i brendshëm, funksionet e pajtueshmërisë dhe kontrollit të brendshëm luajtën rol të rëndësishëm në mbështetjen e stabilitetit institucional dhe sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të operacioneve. Gjatë vitit u ndërmorën aktivitete të vazhdueshme për forcimin e proceseve të monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit të rreziqeve në përputhje me kërkesat rregullative dhe praktikat më të mira të sektorit.

Institucioni po ashtu vazhdoi të investojë në zhvillimin profesional të stafit dhe forcimin e kulturës institucionale, duke e konsideruar kapitalin njerëzor një ndër faktorët kryesorë të suksesit dhe zhvillimit afatgjatë.

Përveç aktiviteteve financiare dhe operative, KEP Trust mbeti aktiv në mbështetjen e iniciativave me ndikim social dhe ekonomik, duke kontribuar në zhvillimin e komuniteteve dhe në avancimin e praktikave të qëndrueshme në përputhje me objektivat institucionale.

MISIONI

Misioni i KEP Trust është të përmirësojë standardin e jetesës dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit, duke ofruar qasje në shërbime financiare për individët dhe bizneset që përballen me vështirësi në sigurimin e burimeve të nevojshme financiare.

Qëllimi ynë është të ofrojmë shërbime financiare të besueshme, të qasshme dhe të përshtatura sipas nevojave specifike të secilit klient që e shërbejmë.



PROFILI I INSTITUCIONIT

KEP Trust është institucion mikrofinanciar me përvojë të gjatë në ofrimin e produkteve kreditore në Kosovë.

Që nga themelimi në vitin 1999, institucioni ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e përfshirjes financiare dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik, duke u fokusuar veçanërisht në segmentet që shpesh kanë qasje të kufizuar në financim.

Institucioni ofron një gamë të gjerë produktesh kreditore për individë, biznese mikro, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, fermerë e biznese në fushën e bujqësisë . Përmes këtyre produkteve kreditore, KEP Trust mbështet investimet, zgjerimin e aktiviteteve ekonomike, rritjen e kapitalit qarkullues, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.


Me një rrjet të gjerë degësh në të gjithë territorin e Kosovës dhe me investime të vazhdueshme në teknologji dhe transformim digjital, KEP Trust synon të sigurojë qasje të lehtë, efikase dhe të sigurt në shërbimet kreditore për klientët e tij.

Institucioni kombinon afërsinë me klientët dhe njohjen e tregut lokal me praktika moderne të menaxhimit, kontrollit të rrezikut dhe qeverisjes institucionale.

KEP Trust është i përkushtuar edhe ndaj zhvillimit të qëndrueshëm social. Përmes iniciativave të ndryshme në fushën e edukimit, ndërmarrësisë, bujqësisë, sportit, kulturës dhe përfshirjes sociale, institucioni kontribuon në krijimin e mundësive të reja për individët dhe komunitetet, duke mbetur i fokusuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse.

4. STRUKTURA ORGANIZATIVE





5. MESAZHI I KRYETARIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Si kryetar i Bordit të Drejtorëve, kam kënaqësinë e veçantë të prezantoj raportin vjetor të KEP Trust për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2025. Ky vit përfaqëson një dëshmi të qartë të rritjes sonë të vazhdueshme, fuqisë institucionale dhe përkushtimit të palëkundur për zgjerimin e qasjes gjithëpërfshirëse në financa.

Gjatë vitit 2025, KEP Trust realizoi edhe një vit me performancë të fortë dhe të qëndrueshme. Portofoli bruto i kredive aktive u rrit për 23.6 milionë euro, duke shënuar rritje prej 21% krahasuar me vitin 2024 dhe duke arritur në 139 milionë euro, çka e pozicionon institucionin si lider të tregut me rreth 27.7% pjesëmarrje.

Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga kreditimi për bizneset dhe bujqësinë, të cilat përbënin rreth 85% të rritjes së përgjithshme të portofolit, duke forcuar më tej rolin tonë si partner kyç për fermerët, ndërmarrësit dhe ekonominë reale.

Gjatë vitit, institucioni shpërndau 112.8 milionë euro përmes 28,844 kredive, duke vazhduar mbështetjen për një bazë të gjerë klientësh në të gjithë vendin. Njëkohësisht, zgjeruam bazën tonë të klientëve me 2,753 klientë të rinj, duke arritur në gjithsej 37,602 klientë aktivë dhe rreth 26.9% pjesëmarrje në treg.

Me rëndësi të veçantë është fakti se kjo rritje u shoqërua me ruajtjen e cilësisë së portofolit dhe menaxhim të kujdesshëm të rrezikut. Portofoli në rrezik mbi 30 ditë mbeti në nivel shumë të shëndetshëm prej 1.55%, duke reflektuar fuqinë e proceseve tona kreditore dhe disiplinën operacionale. Një nga momentet përcaktuese të vitit 2025 ishte tranzicioni i suksesshëm në udhëheqjen ekzekutive të institucionit. Emërimi i kryeshefit të ri ekzekutiv dhe kryeshefes financiare u realizua në mënyrë të qetë dhe të mirëorganizuar, duke siguruar vazhdimësi, stabilitet dhe qartësi strategjike.

Ky tranzicion i suksesshëm reflekton maturinë e institucionit tonë dhe fuqinë e strukturave tona të qeverisjes. Jemi të bindur se ekipi i ri udhëheqës, i mbështetur nga një bord menaxhues me përvojë dhe staf i përkushtuar, do të vazhdojë të ndërtojë mbi themelet e forta të KEP Trust dhe të udhëheqë institucionin në fazën e ardhshme të zhvillimit.



Teksa vazhdojmë të rritemi dhe zhvillohemi, viti 2025 ishte gjithashtu një vit reflektimi dhe qartësimi strategjik. KEP Trust ndërmori hapa të qëllimshëm për të forcuar më tej identitetin si institucion i orientuar drejt ndikimit, duke u rikthyer me fokus të ri tek rrënjët dhe misioni themelues.

Në thelb të veprimtarisë sonë qëndron fuqizimi i individëve, bizneseve të vogla dhe prodhuesve bujqësorë, përmes ofrimit të shërbimeve financiare të qasshme, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ndonëse rritja dhe performanca mbeten të rëndësishme, ato nuk janë qëllim në vetvetë, por mjete përmes të cilave krijojmë ndikim të qëndrueshëm dhe domethënës.

Ky fokus i ripërtërirë siguron që rritja jonë e ardhshme të mbetet e lidhur ngushtë me misionin tonë, duke prioritzuar segmentet më pak të shërbyera, mbështetur jetesën e qëndrueshme dhe kontribuar në zhvillimin më të gjerë ekonomik të Kosovës.

Teksa shohim drejt vitit 2026, e bëjmë këtë me besim dhe drejtim të qartë strategjik. Do të vazhdojmë të fokusohemi në zgjerimin e pranisë sonë, forcimin e segmenteve kryesore të kreditimit, ruajtjen e cilësisë së lartë të portofolit dhe avancimin e efikasitetit operacional, duke mbetur njëkohësisht të ankoruar fuqishëm në qasjen tonë të orientuar nga misioni. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojmë të ndjekim me kujdes zhvillimet rregullative dhe ndryshimet në treg, duke siguruar që KEP Trust të mbetet institucion fleksibil, rezistent dhe me orientim drejt së ardhmes.

Në emër të Bordit të Drejtorëve, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të singertë për menaxhmentin dhe stafin tonë për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre, për partnerët dhe huadhënësit tanë për mbështetjen e vazhdueshme, si dhe për Bankën Qendrore të Kosovës dhe të gjitha palët tjera të interesit për besimin dhe bashkëpunimin.

Së bashku do të vazhdojmë të ndërtojmë mbi trashëgiminë tonë, duke kombinuar performancën e fortë me ndikimin domethënës dhe do të forcojmë më tej pozitën e KEP Trust si institucion lider i përkushtuar ndaj rritjes gjithëpërfshirëse.

Me respekt,
Korab R. Sejdiu
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

5.1 MESAZHI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Me krenari të madhe ju paraqes raportin vjetor të KEP Trust për vitin 2025, një vit që u ndërtua mbi sukseset e mëparshme dhe u karakterizua me rritje të qëndrueshme, forcim institucional dhe përkushtim ndaj misionit tonë për përfshirje financiare dhe zhvillim ekonomik.

Jemi të kënaqur të raportojmë se portofoli i kredive arriti në 139 milionë euro me mbi 37 mijë klientë aktivë, duke konsoliduar më tej pozitën tonë si institucioni udhëheqës mikrofinanciar në vend dhe duke vazhduar të ofrojmë zgjidhje financiare të qasshme dhe të përgjegjshme për individët dhe bizneset në të gjithë Kosovën.

Në themel të të gjitha këtyre arritjeve qëndrojnë njerëzit tanë. Stafi ynë ishte forca kryesore që mundësoi këtë progres, përmes profesionalizmit, përkushtimit dhe afërsisë së vazhdueshme me klientët. Po ashtu, mbështetja dhe udhëheqja e Bordit të Drejtorëve ishin thelbësore në orientimin strategjik dhe në sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të institucionit.

Përkrahja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për sektorin e bujqësisë, mbeti shtylla kryesore e rritjes sonë. Gjatë këtij viti vazhduam të forcojmë partneritetet tona strategjike me institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët tanë mbetën shtyllë e rëndësishme për sigurimin e burimeve të qëndrueshme financiare, ndërsa zgjerimi i bashkëpunimit me bankat vendore krijoi mundësi të reja për sinergji dhe zhvillim të mëtejshëm.



Ndërsa shohim përpara drejt vitit 2026, e bëjmë këtë me besim dhe vizion të qartë. Do të vazhdojmë të zgjerojmë qasjen në financa, të forcojmë segmentet tona kyçe dhe të përshpejtojmë transformimin digjital, duke ofruar shërbime gjithnjë e më efikase dhe të qasshme. Në fokus do të kemi angazhimin tonë për financimin e bujqësisë së qëndrueshme, duke mbështetur fermerët që investojnë në praktika moderne dhe miqësore me mjedisin. Njëkohësisht, do të rrisim fuqizimin e grave në biznes, duke zgjeruar qasjen e tyre në financa dhe duke mbështetur zhvillimin e ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë. Në linjë me angazhimet tona për qëndrueshmëri, do të avancojmë më tej edhe ofertën e kredive të gjelbra, duke kontribuar në investime që përmirësojnë efikasitetin energjetik dhe reduktojnë ndikimin në mjedis. Mbi të gjitha, do të mbetemi të përkushtuar ndaj misionit tonë, të krijojmë ndikim të qëndrueshëm duke fuqizuar individët, bizneset dhe komunitetet në të gjithë vendin.

Ju faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Me përkushtimin e përbashkët të ekipit tonë dhe partnerëve tanë, jemi të bindur se KEP Trust do të vazhdojë të jetë një shtyllë e rëndësishme e përfshirjes financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.

Me respekt,
Adrian Alo
Kryeshef ekzekutiv

6. PËRMBLEDHJE E TREGUT DHE POZICIONIMI STRATEGJIK

GJENDJA EKONOMIKE NË KOSOVË

Gjatë vitit 2025, ekonomia e Kosovës vazhdoi të karakterizohet nga një stabilitet relativ dhe rritje ekonomike e qëndrueshme.

Sipas vlerësimeve zyrtare, ekonomia shënoi rritje prej rreth 4%, duke mbetur në linjë me trendet e rajonit, ndonëse në nivel pak më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Në aspektin nominal, bruto produkti vendor arriti vlerën prej rreth 11 miliardë eurosh.

Rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga konsumi i brendshëm, investimet publike dhe investimet e huaja direkte, si dhe nga sektori i shërbimeve dhe tregtisë, derisa remitancat vazhduan të luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen e konsumit dhe aktivitetit ekonomik.

Gjatë vitit, ekonomia u përball edhe me sfida të vazhdueshme të inflacionit. Inflacioni prej rreth 5% ndikoi në fuqinë blerëse të qytetarëve, veçanërisht përmes rritjes së çmimeve të ushqimit dhe energjisë.

Megjithatë, krahasuar me vitet paraprake, presionet e inflacionit ishin më të moderuara. Në tregun e punës u shënuan përmirësime graduale, me rënie të lehtë të papunësisë, e cila mbeti rreth 10%. Pavarësisht këtij përmirësimi, papunësia vazhdoi të mbetet sfidë, veçanërisht për të rinjtë.

Në anën tjetër, sektori prodhues dhe eksportet mbetën relativisht të kufizuara. Si rezultat, vendi vazhdoi të karakterizohet nga deficit tregtar i lartë dhe varësi e konsiderueshme nga importet.



6.1 ZHVILLIMET NË SEKTORIN FINANCIAR DHE MIKROFINANCIAR

Sektori financiar në Kosovë mbeti një ndër segmentet më të qëndrueshme të ekonomisë gjatë vitit 2025. Sistemi bankar vazhdoi të karakterizohet nga një kapitalizim i mirë dhe cilësi e qëndrueshme e portofolit të kredive, me nivel të ulët të kredive joperformuese.

Aktiviteti kreditues shënoi rritje të konsiderueshme, duke mbështetur kryesisht bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe kreditimin konsumator. Kreditë ndaj sektorit privat u rritën me rreth 15% – 16%, ndërsa depozitat vazhduan trendin pozitiv të rritjes, duke reflektuar besimin e qytetarëve dhe bizneseve në sistemin financiar. Në këtë mjedis, sektori mikrofinanciar vazhdoi të luajë rol të rëndësishëm në rritjen e përfshirjes financiare dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal.

Institucionet mikrofinanciare kontribuan në financimin e mikro bizneseve, sektorit të bujqësisë, si dhe në fuqizimin ekonomik të grave. Gjatë vitit 2025, sektori mikrofinanciar vazhdoi rritjen e qëndrueshme të aktivitetit. Portofoli i kredive të institucioneve mikrofinanciare anëtare të AMIK arriti rreth 500 milionë euro, ndërsa norma e rritjes së kreditimit ishte rreth 23% në nivel vjetor. Cilësia e portofolit mbeti e qëndrueshme, me portfol në rrezik mbi 30 ditë prej rreth 1.6%.

Megjithatë, sektori vazhdoi të përballlet me sfida si kosto relativisht më e lartë e financimit, nevoja për diversifikim të produkteve financiare dhe sigurimi i burimeve më të favorshme të financimit.

7. ZHVILLIMI I BIZNESIT

Gjatë vitit 2025, KEP Trust vazhdoi të shënojë rritje të qëndrueshme të aktivitetit kreditues dhe zhvillim të mëtejshëm të portofolit të kredive, duke forcuar pozicionin si një ndër institucionet kryesore mikrofinanciare në Kosovë.

Performanca e institucionit gjatë vitit u karakterizua nga zgjerimi i bazës së klientëve, rritja e shpërndarjeve, zhvillimi i produkteve prioritare dhe mbështetja e vazhdueshme ndaj bizneseve, sektorit të bujqësisë dhe ekonomive familjare. Aktiviteti i kreditimit gjatë vitit 2025 u zhvillua në një mjedis ekonomik relativisht stabil, por të karakterizuar nga presione të inflacionit dhe sfida në fuqinë blerëse të qytetarëve. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, kërkesa për financim mbeti e qëndrueshme, veçanërisht nga bizneset e vogla dhe të mesme, sektori i bujqësisë dhe klientët individualë.

Në këtë kontekst, KEP Trust vazhdoi të luajë rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe rritjen e përfshirjes financiare në vend.



7.1 PORTOFOLI DHE RITJA E KLIENTËVE

Portofoli bruto i kredive shënoi performancë të fortë gjatë vitit 2025, duke reflektuar rritjen e aktivitetit kreditues dhe zgjerimin e marrëdhënieve me klientët ekzistues dhe të rinj. Portofoli u rrit nga 116 milionë euro në 139 milionë euro, duke shënuar rritje prej 21% krahasuar me vitin paraprak.

Kjo rritje reflekton jo vetëm zgjerimin e kreditimit, por edhe rritjen e madhësisë mesatare të kredive dhe orientimin e institucionit drejt financimit më të strukturuar të klientëve dhe aktiviteteve ekonomike me potencial zhvillimor. Gjatë vitit, pati edhe zgjerim të bazës së klientëve aktivë. Numri i klientëve u rrit me 7.9%, duke reflektuar besimin e klientëve, praninë e gjerë në treg dhe aftësinë për të adresuar nevojat financiare të segmenteve të ndryshme të klientëve në zonat urbane dhe rurale.


Rritja e klientëve dhe zgjerimi i portofolit u mbështetën nga qasja e institucionit në ofrimin e financimit fleksibil, proceset efikase operacionale dhe fokusimi në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët.

Në fund të vitit 2025, KEP Trust përfaqësonte 27.7% të portofolit të përgjithshëm të sektorit mikrofinanciar dhe 26.9% të numrit të klientëve aktivë. Këta tregues reflektojnë zhvillimin e vazhdueshëm të aktivitetit kreditues, zgjerimin e marrëdhënieve me klientët dhe angazhimin e institucionit për t'iu përgjigjur nevojave financiare të segmenteve të ndryshme të tregut.

Pjesëmarrja në treg sipas portofolit - 2025



Pjesëmarrja në treg sipas numrit të klientëve aktivë - 2025



7.2 SHPËRNDARJET E KREDIVE

Institucioni realizoi shpërndarje në vlerë prej 112.8 milionë eurosh përmes 28,844 kredive të aprovuara për klientët. Krahasuar me vitin 2024, shpërndarjet shënuan rritje prej 15.2%, duke reflektuar zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe kërkesën e vazhdueshme për financim.

Madhësia mesatare e kredisë ishte rreth 3,900 euro, çka reflekton fokusin e institucionit në financimin e mikro bizneseve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, aktiviteteve bujqësore dhe nevojave të ekonomive familjare. Rritja e shpërndarjeve u mbështet nga rrjeti i degëve, qasja e afërt me klientët dhe vazhdimi i përmirësimit të proceseve të shërbimit dhe analizës kreditore. Institucioni vazhdoi të fokusohet në ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe fleksibile, duke ruajtur njëkohësisht standarde të menaxhimit të rrezikut dhe cilësisë së portofolit.

Përmes aktivitetit kreditues, KEP Trust vazhdoi të mbështesë zhvillimin e bizneseve lokale, investimet në sektorin e bujqësisë, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të klientëve në komunitetet ku operon.

7.3 PERFORMANCA E PRODUKTEVE

Pjesa më e madhe e produkteve kreditore shënuan performancë pozitive dhe rritje të konsiderueshme, duke reflektuar fokusin strategjik në segmentet me potencial më të lartë të zhvillimit.

Kreditë për biznes mbetën produkti kryesor në portofolin e institucionit, me balancë prej 35.3 milionë eurosh dhe rritje prej 25.9% krahasuar me vitin paraprak. Performanca e këtij produkti reflekton rolin e rëndësishëm të KEP Trust në mbështetjen e zhvillimit të bizneseve lokale, investimeve dhe aktiviteteve prodhuese në vend.

Njëkohësisht, kreditë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme shënuan performancën më të lartë në aspektin e rritjes, duke u rritur me 43.6% dhe duke arritur vlerën prej 20.1 milionë eurosh. Ky produkt vazhdoi të jetë një ndër shtytësit kryesorë të zgjerimit të portofolit, duke reflektuar kërkesën në rritje për financim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Edhe kreditë për bujqësi vazhduan trendin pozitiv të rritjes. Balanca e këtij produkti arriti në 29.1 milionë euro, duke shënuar rritje prej 29.8% krahasuar me vitin paraprak. Kjo performancë reflekton rëndësinë strategjike të sektorit të bujqësisë në aktivitetin e institucionit dhe angazhimin e vazhdueshëm në mbështetjen e fermerëve dhe agro bizneseve.

Ndërkohë, produktet për përmirësim të kushteve të banimit dhe produktet “Ekspres” patën performancë stabile gjatë vitit, duke shënuar rritje më të moderuar prej 8.2%. Këto produkte vazhduan të kontribuojnë në diversifikimin e portofolit dhe adresimin e nevojave të ndryshme financiare të klientëve.

Performanca pozitive e produkteve kreditore gjatë vitit 2025 reflekton strategjinë e institucionit për ruajtjen e një portofoli të balancuar dhe të diversifikuar, me fokus në mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe përfshirjes financiare.

7.4 ANALIZA E RRIJTJES

Rritja e aktivitetit u mbështet nga disa faktorë, përfshirë kërkesën e vazhdueshme për financim, zgjerimin e marrëdhënieve me klientët ekzistues, rritjen e madhësisë mesatare të kredive dhe fokusimin në produktet me potencial më të lartë të zhvillimit.

Një rol të rëndësishëm në këtë rritje pati financimi i bizneseve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat vazhduan të kërkojnë financim për investime, zgjerim të aktiviteteve dhe rritje të kapitalit qarkullues. Po ashtu, sektori i bujqësisë mbeti një ndër kontribuesit kryesorë të zgjerimit, duke reflektuar rëndësinë e këtij sektori në ekonominë e vendit.

Gjatë vitit, institucioni vazhdoi të investojë në përmirësimin e proceseve operacionale, zhvillimin e produkteve dhe përmirësimin e përvojës së klientit, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe zgjerimin e aktivitetit kreditues.

Diversifikimi i portofolit ndërmjet produkteve të ndryshme kreditore dhe ruajtja e cilësisë mbetën elemente të rëndësishme të strategjisë së institucionit për rritje të qëndrueshme dhe menaxhim efektiv të rrezikut.

8. KOMUNIKIMI I MARKETINGUT

Aktivitetet e marketingut dhe komunikimit gjatë vitit 2025 u fokusuan në mbështetjen e objektivave strategjike të institucionit, rritjen e portofolit kreditor, forcimin e pozicionimit të brendit dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve.

Vëmendje e veçantë iu kushtua kredive për biznes dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), përkrahjes së grave ndërmarrëse, si dhe financimit të sektorit të bujqësisë, në përputhje me prioritetet strategjike të institucionit. Komunikimi me audiencat e synuara u realizua përmes një kombinimi të kanaleve digjitale dhe tradicionale, duke mundësuar shtrirje të gjerë dhe komunikim të vazhdueshëm me klientët ekzistues dhe potencialë. Kanalet digjitale, veçanërisht rrjetet sociale dhe portalet informative, u përdorën për promovimin e produkteve, fushatave tematike dhe aktiviteteve institucionale, ndërsa kanalet tradicionale, përfshirë materialet informuese në degë dhe reklamën në radio, vazhduan të mbështesin prezencën e institucionit në treg.

Përveç promovimit të produkteve dhe shërbimeve, aktivitetet e komunikimit kontribuan në forcimin e pozitës së KEP Trust si institucion i besueshëm, profesional dhe i përkushtuar ndaj zhvillimit ekonomik dhe përfshirjes financiare.

Përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe aktiviteteve të ndryshme promovuese, institucioni vazhdoi të ndërtojë dhe forcojë identitetin e tij si partner afatgjatë për klientët dhe komunitetin.



9. SHËRBIMI NDAJ KLIENTËVE

Përvoja e klientit dhe cilësia e shërbimit vazhduan të jenë ndër prioritetet kryesore të KEP Trust gjatë vitit 2025. Institucioni mbeti i përkushtuar ndaj ndërtimit të marrëdhënieve afatgjata me klientët, ofrimit të shërbimeve cilësore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të përvojës së tyre në të gjitha pikat e kontaktit me institucionin.

Matjet dhe analizat e realizuara përmes proceseve të brendshme treguan reagime pozitive nga klientët, të cilët vlerësuan profesionalizmin e stafit, transparencën në komunikim, gatishmërinë për të ndihmuar dhe shpejtësinë në trajtimin e kërkesave. Qendra e thirrjeve vazhdoi të luajë rol të rëndësishëm në ofrimin e informatave, mbështetjen e klientëve dhe identifikimin e nevojave dhe pritshmërive të tyre.

Gjatë vitit u realizua edhe një hulumtim i pavarur për matjen e kënaqshmërisë së klientëve, i cili konfirmoi nivel të lartë të besimit dhe kënaqshmërisë ndaj KEP Trust. Rezultatet treguan se klientët vlerësojnë veçanërisht sjelljen dhe profesionalizmin e stafit, transparencën gjatë komunikimit dhe efikasitetin e procesit të aplikimit. Po ashtu, niveli i besnikërisë dhe gatishmërisë së klientëve për të rekomanduar institucionin rezultoi i lartë.

Përmes kombinimit të analizave të brendshme dhe hulumtimeve të jashtme, KEP Trust vazhdoi të forcojë qasjen e orientuar drejt klientit, duke mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme të bazuara në besim dhe profesionalizëm.



10. TRANSFORMIMI DIGJITAL

Gjatë vitit 2025, KEP Trust vazhdoi avancimin e transformimit digjital përmes zhvillimit të sistemeve, proceseve dhe kanaleve elektronike, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional dhe mbështetjen e zhvillimit të institucionit.

Forma online e aplikimit për kredi vazhdoi të jetë një nga kanalet kryesore të pranimit të kërkesave, duke mundësuar proces më të shpejtë dhe më të lehtë të aplikimit. Integrimi i proceseve digjitale me qendrën e thirrjeve dhe rrjetin e degëve kontribuoi në koordinim më efikas dhe trajtim më të shpejtë të kërkesave.

Gjatë vitit u realizuan gjithashtu zhvillime dhe përmirësime të sistemeve ekzistuese, me fokus në automatizimin e proceseve, avancimin e qasjes në informata dhe rritjen e efikasitetit operacional. Investimet në teknologji dhe zhvillimet e reja digjitale krijuan bazë të qëndrueshme për modernizimin e mëtejshëm të proceseve dhe shërbimeve të institucionit.

Transformimi digjital mbetet një nga prioritetet strategjike të KEP Trust, me fokus në modernizimin e vazhdueshëm të proceseve, rritjen e efikasitetit operacional dhe krijimin e kapaciteteve të reja për zhvillimin e institucionit në të ardhmen.



11. PERFORMANCA FINANCIARE


Gjatë vitit 2025, KEP Trust vazhdoi trendin e rritjes dhe konsolidimit financiar, duke reflektuar performancë të qëndrueshme operacionale, zgjerim të aktivitetit kreditues dhe menaxhim efektiv të portofolit të kredive. Totali i aseteve arriti në 149.5 milionë euro, duke shënuar rritje prej 23.2% krahasuar me vitin paraprak (121.4 milionë euro). Struktura e aseteve mbeti e dominuar nga kreditë për klientë, të cilat arritën në 139 milionë euro (bruto), duke reflektuar kërkesën e vazhdueshme për financim dhe zgjerimin e aktivitetit kreditues.

Portofoli i kredive u rrit me 21%, ndërsa huamarrjet u rritën me 26.6%, duke mbështetur financimin e rritjes së aktivitetit dhe zgjerimin e operacioneve.


Detyrimet totale arritën në 108.7 milionë euro, krahasuar me 86.3 milionë euro në vitin 2024.

Teprica për vitin 2025 arriti në 5.8 milionë euro, duke shënuar rritje prej rreth 29% krahasuar me vitin paraprak (4.5 milionë euro). Kjo performancë u mbështet nga rritja e të ardhurave, menaxhimi efektiv i kostove dhe stabiliteti i cilësisë së portofolit kreditor. Teprica e akumuluar e institucionit arriti në 40.8 milionë euro, duke përforcuar bazën financiare dhe kapacitetin për rritje të qëndrueshme në të ardhmen.

Në milionë euro



Në milionë euro



11.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET


Të ardhurat nga interesi vazhduan të mbeten burimi kryesor i të ardhurave, duke arritur në 21.7 milionë euro, krahasuar me 17.9 milionë euro në vitin 2024. Rritja reflekton zgjerimin e portofolit kreditor dhe menaxhimin e mirë të të ardhurave nga aktiviteti kreditues.

Shpenzimet operative arritën në 9.6 milionë euro, nga 8.5 milionë euro në vitin paraprak. Rritja lidhet kryesisht me zgjerimin e aktiviteteve operacionale dhe investimet në kapacitetet njerëzore, ku shpenzimet e personelit arritën në 5.6 milionë euro.


Ndërkohë, shpenzimet për humbjet nga kreditë shënuan ulje të lehtë, duke rënë nga 1.11 milionë euro në 1.04 milionë euro. Kjo reflekton stabilitetin e cilësisë së portofolit kreditor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të menaxhimit të rrezikut kreditor.

Raporti ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve mbeti i qëndrueshëm, duke reflektuar efikasitet të mirë operacional. Rritja e të ardhurave tejkaloi rritjen e shpenzimeve, duke kontribuar në përmirësimin e profitabilitetit dhe forcimin e performancës së përgjithshme financiare.

Në milionë euro



Në milionë euro



11.2 LIKUIDITETI DHE BURIMET E FINANCIMIT

KEP Trust vazhdoi të menaxhojë në mënyrë efektive likuiditetin dhe burimet financiare. Paraja dhe ekuivalentët e saj arritën në 10.1 milionë euro, krahasuar me 5.6 milionë euro në vitin paraprak, duke reflektuar pozicion të qëndrueshëm të likuiditetit.

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese ishte pozitive dhe arriti në 16.3 milionë euro, duke mbështetur financimin e shpërndarjeve të kredive dhe nevojat operacionale të institucionit.

Menaxhimi i kujdesshëm i rrjedhës së parasë dhe sigurimi i burimeve të qëndrueshme të financimit i mundësuan institucionit të ruajë stabilitet financiar dhe fleksibilitet operacional në mbështetje të rritjes së vazhdueshme të aktivitetit.

12. MENAXHIMI I RREZIKUT

Menaxhimi i rrezikut përbën një komponent thelbësor në strukturën operacionale dhe strategjike të KEP Trust, si institucion lider në sektorin mikrofinanciar në vend.

Duke operuar në një mjedis financiar dinamik, institucioni përballet me rreziqe që mund të ndikojnë në performancën, vazhdimësinë e shërbimeve dhe pozitën financiare. Rreziqet janë të ndërlidhura, duke qenë se përqekësimi i cilësisë së portofolit mund të reflektohet në likuiditet dhe financim, ndërsa ngjarjet operative mund të ndikojnë në efikasitet, sigurinë dhe besimin e klientëve.

Në këtë kapitull paraqiten rreziqet kryesore të identifikuara gjatë vitit 2025, përfshirë rrezikun kreditor, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit, rrezikun valutor dhe rrezikun e normës së interesit.

Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe rritjen afatgjatë, institucioni ka zhvilluar politika, kontrolle dhe mekanizma të brendshëm për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe zbutjen e rreziqeve, duke përcaktuar përgjegjësi të qarta dhe raportim të rregullt menaxherial.

Menaxhimi efektiv i rrezikut nuk është vetëm një kërkesë rregullore, por një domosdoshmëri për ruajtjen e besueshmërisë ndaj investorëve, klientëve dhe palëve të tjera të interesit. Po ashtu, qasja e KEP Trust bazohet në kulturën institucionale të ndërgjegjësimit për rrezikun dhe në masa parandaluese, me synim që ekspozimet të mbahen brenda kufijve të pranuar. Në këtë kuadër, jo të gjitha rreziqet kanë të njëjtën peshë apo materialitet.

Nënseksionet vijuese paraqesin profilin e secilit rrezik dhe masat konkrete të ndërmarra gjatë vitit 2025 për menaxhimin e tyre.



12.1 RREZIKU KREDITOR

Rreziku kreditor mbetet rreziku kryesor për KEP Trust, duke qenë se portofoli i kredive përbën pjesën më të madhe të aktiviteteve të institucionit.

Në vitin 2025, ky rrezik është karakterizuar nga ndryshime në kapacitetin pagues të një pjese të klientëve, si rezultat i faktorëve makroekonomikë dhe gjeopolitikë, përfshirë presionet e inflacionit, migrimin e një pjese të klientëve dhe pasiguritë në mjedisin ndërkombëtar. Në këtë kuadër, është kërkuar një qasje e kujdesshme për ruajtjen e cilësisë së portofolit në kushtet e një mjedisi financiar dinamik.

Objektivat e menaxhimit të rrezikut kreditor gjatë vitit 2025 janë orientuar në: ruajtjen e një portofoli kreditor me cilësi të lartë, kufizimin e përqendrimit të ekspozimeve sipas produkteve/segmenteve dhe zonave gjeografike dhe sigurimin e mbulimit adekuat të humbjeve të pritshme përmes provizioneve, në përputhje me politikat e brendshme dhe kërkesat rregullatore.

Këto objektiva operacionalizohen përmes standardeve të vlerësimit, monitorimit dhe ndërhyrjeve të hershme gjatë gjithë ciklit të kredisë. Menaxhimi i këtij rreziku zbatohet përgjatë gjithë ciklit të kredisë, përmes vlerësimit rigoroz të kapacitetit pagues dhe të ngarkesës ekzistuese me kredi, vendim-marrjes së standardizuar, monitorimit të rregullt pas shpërndarjes dhe trajtimit proaktiv të kredive me vonesë.

Gjatë vitit 2025, vëmendje e veçantë i është kushtuar parandalimit të mbingarkesës me kredi dhe forcimit të sinjaleve të hershme, për të identifikuar dhe adresuar në kohë çdo përkeqësim potencial.

Mbi këtë bazë, janë ndërmarrë edhe masa të dedikuara për menaxhimin e vonesave dhe ruajtjen e disiplinës së pagesave.

Si masa konkrete të ndërmarra gjatë vitit 2025 për menaxhimin e vonesave dhe ruajtjen e cilësisë së portofolit, KEP Trust ka funksionalizuar segmentin arkëtim i kujdesshëm, me fokus në vetëdijesimin e klientëve dhe rikujtimin në kohë të detyrimeve kreditore, si dhe ka themeluar komitetin e vonesave si mekanizëm i brendshëm për menaxhimin e kredive me vonesë dhe sigurimin e një vendimmarrjeje të koordinuar mbi trajtimin e tyre.

Përmes një qasjeje parandaluese dhe këshilluese, këto masa mbështesin klientët në menaxhimin e pagesave, ruajnë disiplinën e pagesave dhe minimizojnë përshkallëzimin drejt masave ligjore ndaj klientëve në vonesë. Paralelisht, institucioni ka vazhduar të investojë në standardizimin dhe automatizimin e vendimmarrjes kreditore.

Për të ruajtur një balancë të qëndrueshme ndërmjet rritjes dhe ekspozimit ndaj rrezikut gjatë vitit 2025, KEP Trust ka vazhduar harmonizimin e proceseve kreditore me zhvillimet teknologjike.

Në këtë drejtim, karta vlerësuese është përdorur si mjet i automatizuar për vendimmarrjen për kreditë deri në 2,000 euro, ndërsa gjatë vitit është avancuar pilotimi i një mjeti të ngjashëm për kreditë deri në 5,000 euro.

Këto ndërhyrje kanë rritur standardizimin e vendimarrjes, kanë përmirësuar konsistencën e vlerësimit të rrezikut dhe kanë shkurtuar kohën e përgjigjes ndaj klientëve. Për të përforcuar më tej këtë qasje të bazuar në të dhëna, institucioni ka zgjeruar përdorimin e modeleve analitike në vlerësimin e kredive.

Përdorimi i modeleve ekonometrike në vlerësimin e kredive ka kontribuar në forcimin e disiplinës kreditore dhe në përmirësimin e cilësisë së vlerësimit të rrezikut, duke mbështetur vendimarrjen mbi baza të dhënash dhe duke reduktuar varësinë nga gjykimi subjektiv.

Paralelisht, kjo qasje ka rritur efikasitetin operacional në procesin e kreditimit dhe ka ndihmuar në ruajtjen e performancës së portofolit përmes segmentimit më të saktë të rrezikut dhe përcaktimit më të përshtatshëm të kushteve të kreditimit.

12.2 RREZIKU OPERACIONAL

Rreziku operacional përfshin humbjet që rrjedhin nga procese të papërsosura, gabime njerëzore, dështime të sistemeve apo ngjarje të jashtme. Gjatë vitit 2025, në një mjedis gjithnjë më të digjitalizuar dhe me kërkesa në rritje për shërbim të shpejtë e të sigurt, fokusi i institucionit ka qenë forcimi i kontrollit të brendshëm, menaxhimi i incidenteve dhe rritja e qëndrueshmërisë operationale për të ruajtur vazhdimësinë e shërbimeve dhe besimin e klientëve.

Institucioni ka ngritur struktura dhe procedura të dedikuara për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e rrezeqeve operative, me përgjegjësi të qarta dhe raportim të rregullt menaxherial.

Menaxhimi i incidenteve bazohet në raportimin në kohë, klasifikimin sipas rëndësisë, analizën e shkaqeve rrënjësore dhe zbatimin e masave korrigjuese e parandaluese, me synim zvogëlimin e përsëritjes së incidenteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve. Për të adresuar rrezeqet që lidhen me njerëzit dhe proceset, gjatë vitit 2025 janë forcuar masat e kontrollit të brendshëm si p.sh. ndarja e detyrave, autorizimet dhe verifikimet e dyfishta, si dhe mekanizmat për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve. Menaxhimi i rrezikut operacional mbulon gjithashtu edhe rrezeqet që burojnë nga palët e treta dhe furnitorët, përmes monitorimit të performancës, kërkesave kontraktuale dhe vlerësimit periodik të rrezikut të tyre.

Në kontekstin e digjitalizimit, institucioni u ka kushtuar vëmendje të veçantë rrezeqeve të teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike, duke forcuar kontrollet e qasjen, mbrojtjen e të dhënave, praktikat e kopjeve rezervë dhe ndërgjegjësimin e stafit ndaj kërcënimeve si “phishing”.

Paralelisht, testimi i vazhdueshëm i planeve të vazhdimësisë së biznesit dhe rikuperimit pas ndërprerjeve ka synuar të sigurojë që proceset kritike të mund të vazhdojnë edhe në kushte të ndërprerjeve të papritura.

Përmes këtyre masave, KEP Trust ka mbështetur një operim efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm gjatë vitit 2025.

12.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit mbështetet në politika dhe procedura efektive, në përputhje me kërkesat e autoritetit rregullativ dhe standardet e brendshme të menaxhimit financiar. Gjatë vitit 2025, fokusi i institucionit ka qenë ruajtja e aftësisë për të përmbushur obligimet në kohë dhe pa kosto të panevojshme, duke siguruar njëkohësisht vazhdimësinë e financimit të klientëve.

Në vitin 2025, menaxhimi i likuiditetit është mbështetur në parashikimin dhe monitorimin e rregullt të flukseve hyrëse dhe dalëse të parasë, si dhe në menaxhimin e maturiteteve të aseteve dhe detyrimeve për të shmangur mospërputhje të mundshme. Cilësia e portofolit të kredive dhe struktura e kredive në numër të madh, me vlera më të vogla dhe afate relativisht të shkurtra kanë kontribuar në flukse më të parashikueshme të arkëtimit.

Paralelisht, institucioni ka mbajtur rezerva emergjente të likuiditetit dhe limite të brendshme për nivelin minimal të mjeteve likuide, me qëllim krijimin e një hapësire tampon të mjaftueshme për situata të paparashikuara.

Për të rritur qëndrueshmërinë ndaj luhatjeve të mundshme gjatë vitit 2025, KEP Trust ka vijuar diversifikimin e burimeve të financimit dhe bashkëpunimin me kreditues vendorë dhe ndërkombëtarë, duke planifikuar në mënyrë proaktive rifinancimet dhe afatet e obligimeve.

Si pjesë e kornizës së menaxhimit të likuiditetit, institucioni realizon teste të stresit të bazuara në skenarë të paracaktuar për të vlerësuar pozitat e likuiditetit në kushte presioni.

Rezultatet e këtyre analizave përdoren për të rishikuar pozicionin e likuiditetit, për të përditësuar prioritetet e financimit dhe, kur është e nevojshme, për të aktivizuar masa parandaluese që sigurojnë përmbushjen e detyrimeve pa ndërprerë operacionet e institucionit.

Përmes këtyre masave, gjatë vitit 2025 institucioni ka ruajtur një pozicion të shëndetshëm të likuiditetit, duke mbështetur vazhdimësinë e shpërndarjeve dhe stabilitetin e operacioneve në kohë.

12.4 RREZIKU VALUTOR

Rreziku nga valuta e huaj i referohet mundësisë që ndryshimet në kurset e këmbimit valutor të ndikojnë negativisht në rezultatet financiare të një subjekti.

Megjithatë, për KEP Trust, ky lloj rreziku konsiderohet i papërfillshëm, pasi në datën e përgatitjes së bilancit, të gjitha asetet dhe detyrimet financiare janë të denominuara në euro (EUR), e cila është edhe valuta zyrtare e raportimit.

12.5 MENAXHIMI I RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT DHE FINANCIMIT

Rreziku i normës së interesit lidhet me ndikimin që luhatjet e normave të tregut mund të kenë në koston e financimit dhe, rrjedhimisht, në rezultatet financiare dhe politikat e kreditimit të institucionit. Për KEP Trust, menaxhimi i këtij rreziku është i lidhur drejtpërdrejt me strukturën dhe kushtet e huamarrjes.

Gjatë vitit 2025, lëvizjet e normës referuese EURIBOR kanë ndikuar në koston e financimit në treg. Për të ulur ekspozimin ndaj rritjeve të papritura të normave, KEP Trust ka menaxhuar strukturën e financimit përmes një kombinimi të balancuar ndërmjet huamarrjes me normë fikse dhe asaj me normë variable, si dhe përmes planifikimit të afateve të rifinancimit.

Baza e kapitalit ka qenë një element kyç në ruajtjen e stabilitetit financiar, duke vepruar si amortizues ndaj rritjes së kostove të huamarrjes. Kapitali i akumuluar nga performanca e mirë ndër vite ka kontribuar që efekti i luhatjeve të normave të interesit të mbetet i kufizuar dhe i menaxhueshëm.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar analiza të rregullta të ndjeshmërisë dhe simulime të skenarëve të tregut, për të vlerësuar ndikimin potencial në koston e fondeve dhe në marzhin financiar. Këto analiza kanë mbështetur vendimmarrjen për strukturën e financimit dhe masat zbutëse në kohë.

Përmes këtyre masave, KEP Trust ka ruajtur qëndrueshmërinë financiare gjatë vitit 2025 dhe ka mbajtur nën kontroll ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit.

13. AUDITIMI I BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm vazhdoi të luajë rol të rëndësishëm në forcimin e kontrollit të brendshëm, përmirësimin e proceseve operative dhe mbështetjen e qeverisjes së institucionit. Gjatë vitit u realizuan auditime në fusha dhe procese të ndryshme të institucionit, në përputhje me planin vjetor të auditimit dhe kërkesat rregullative. Aktivitetet u koncentruan në vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme, pajtueshmërisë me procedurat dhe rregulloret, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësim operacional.

Rezultatet e auditimeve treguan se gjatë vitit 2025 nuk u identifikuan gjetje materiale, duke reflektuar funksionim të qëndrueshëm të proceseve dhe nivel të mirë të kontrollit të brendshëm në institucion.

Në kuadër të aktiviteteve, u dhanë rekomandime për përmirësime të mëtejshme në procese dhe kontrolle operative, ndërsa gjatë vitit u implementuan gjithsej 30 rekomandime. Implementimi i këtyre rekomandimeve kontribuoi në përmirësimin e proceseve, rritje të efikasitetit operacional dhe ulje të mospërputhjeve me procedurat e brendshme, rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.

Përmes qasjes së vazhdueshme të monitorimit dhe përmirësimit, auditimi i brendshëm vazhdoi të kontribuojë në forcimin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe stabilitetit operacional të institucionit.



14. DEPARTAMENTI JURIDIK/LIGJOR DHE PAJTUESHMËRIA

Gjatë vitit 2025, KEP Trust vazhdoi të forcojë funksionet e pajtueshmërisë dhe mbështetjes ligjore, duke siguruar zhvillimin e aktivitetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat rregullative dhe standardet e brendshme të institucionit.

Përputhshmëria ligjore e aktivitetit financiar është mbështetur përmes zbatimit të një kornize të strukturuar të kontrollit dhe monitorimit, me fokus në ruajtjen e standardeve të larta të qeverisjes, transparencës dhe menaxhimit të rrezikut ligjor.

Departamenti juridik dhe pajtueshmërisë kanë mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme proceset operative dhe kreditorë të institucionit, përfshirë dokumentacionin kontraktual, respektimin e kërkesave ligjore në marrëdhëniet me klientët, si dhe përputhshmërinë me rregulloret dhe udhëzimet e Bankës Qendrore të Kosovës.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjeve që lidhen me transparencën ndaj klientëve, trajtimin korrekt të klientëve, raportimin rregullativ dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme operative.

Gjatë vitit u realizuan rishikime periodike dhe kontrole të brendshme me qëllim identifikimin dhe parandalimin e çdo devijimi nga kërkesat ligjore dhe rregullative.

Këto aktivitete kontribuan në forcimin e kontrollit të brendshëm dhe ruajtjen e nivelit të lartë të përputhshmërisë në të gjitha aktivitetet e institucionit. Në aspektin e menaxhimit të rrezikut ligjor, gjatë vitit 2025 nuk u identifikuan rreziqe ligjore që do të mund të kishin ndikim në operacionet apo reputacionin e KEP Trust.

Menaxhimi i rreziqeve ligjore është realizuar përmes një qasjeje të strukturuar dhe proaktive, duke përfshirë ofrimin e këshillimit të vazhdueshëm ligjor, standardizimin dhe përditësimin e dokumentacionit kontraktual, si dhe monitorimin sistematik të rasteve gjyqësore dhe përmbarimore.

Po ashtu, institucioni vazhdoi bashkëpunimin e ngushtë me institucione relevante dhe partnerë të jashtëm ligjorë, me qëllim mbështetjen efikase të proceseve operative dhe mbrojtjen e interesave të institucionit.

Gjatë vitit u organizuan edhe trajnime për stafin lidhur me çështje ligjore dhe rregullative, ndërsa monitorimi i vazhdueshëm i ndryshimeve në legjislacion mundësoi përshtatjen në kohë të politikave dhe procedurave të brendshme.



15. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROCESEVE – QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE (QMS)

KEP Trust vazhdoi avancimin e organizimit dhe menaxhimit të proceseve, me fokus në përmirësimin e efikasitetit operacional, standardizimin e praktikave të brendshme dhe integrimin më të thellë të parimeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në aktivitetet dhe operacionet e institucionit.

Departamenti i organizimit dhe menaxhimit të proceseve dhe qeverisjes mjedisore dhe sociale u fokusua në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve operative dhe forcimin e koordinimit ndërmjet funksioneve të ndryshme. U avancuan praktikatat e standardizimit të proceseve dhe u zhvilluan më tej mjetet e punës që mbështesin operacionet e përditshme dhe rritjen e efikasitetit institucional.

Në kuadër të avancimit të transformimit operacional, gjatë vitit u zhvilluan mjete me funksionalitete të inteligjencës artificiale, të cilat mbështetën organizimin e punës, qasjen më të shpejtë në informata dhe standardizimin e praktikave të brendshme. Këto zhvillime kontribuan në optimizimin e proceseve, përmirësimin e komunikimit dhe rritjen e efikasitetit operacional në funksione të ndryshme.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 u thellua integrimi i parimeve QMS në proceset e brendshme, si dhe në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e iniciativave të qëndrueshmërisë. Vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së këtyre parimeve edhe në procesin e kreditimit, me qëllim forcimin e vlerësimit të rrezikut dhe ndikimit mjedisor dhe social në vendimmarrjen kreditore.

Në këtë drejtim, KEP Trust vazhdoi të forcojë qasjen drejt financimit të përgjegjshëm dhe mbështetjes së aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Institucioni vazhdoi bashkëpunimin me partnerë dhe fonde me renome ndërkombëtare, me fokus në avancimin e përfshirjes së grave si kliente individuale, ashtu edhe si pronare apo drejtuese biznesesh.

Njëkohësisht, u rrit angazhimi në financimin e projekteve që lidhen me energjinë e pastër, si dhe në promovimin e bujqësisë së mençur dhe praktikave të qëndrueshme në këtë sektor. Përmes këtyre iniciativave, KEP Trust vazhdoi të mbështesë investime që kontribuojnë në uljen e ndikimit mjedisor dhe forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike të klientëve dhe komuniteteve ku operon. Në kuadër të avancimit të praktikave QMS, gjatë vitit u zhvillua edhe procesi për vlerësimin e pavarur të Performancës Sociale të Institucionit (SPI).

U përcaktuan kërkesat relevante, u konsoliduan të dhënat e nevojshme dhe u krijuan parakushtet për realizimin e këtij vlerësimi, i cili pritet të përmbyllet gjatë gjysmës së parë të vitit pasues.

Ky proces synon të forcojë matjen e impaktit social dhe llogaridhënien ndaj palëve të interesit.

Për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të brendshme, stafi i përfshirë në funksionet QMS mori pjesë në trajnime dhe programe ndërkombëtare profesionale, me qëllim përditësimin me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e qëndrueshmërisë dhe financimit të përgjegjshëm.

Në tërësi, iniciativat e realizuara gjatë vitit 2025 kontribuan në përmirësimin e proceseve të brendshme, forcimin e efikasitetit operacional dhe rritjen e impaktit pozitiv të institucionit në shoqëri e mjedis.



16. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Departamenti i teknologjisë së informacionit vazhdoi të luajë rol të rëndësishëm në mbështetjen e operacioneve, avancimin e transformimit digjital dhe forcimin e infrastrukturës teknologjike të institucionit. Përmes investimeve në sisteme, siguri dhe optimizim të proceseve, departamenti kontribuoi në rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e shërbimeve.

Gjatë periudhës raportuese u realizuan një sërë zhvillimesh dhe avancimesh teknologjike, me fokus në përmirësimin e sistemeve ekzistuese, automatizimin e proceseve dhe rritjen e kapaciteteve teknologjike për t'iu përgjigjur nevojave të biznesit. Infrastruktura teknologjike u përmirësua përmes avancimit të pajisjeve të rrjetit, zgjerimit të kapaciteteve të ruajtjes së të dhënave, përditësimit të serverëve dhe furnizimit me pajisje të reja kompjuterike për stafin.

Siguria e informacionit mbeti ndër prioritetet kryesore. Në këtë drejtim u zbatuan masa dhe kontrole të avancuara të sigurisë për mbrojtjen e sistemeve dhe të dhënave, duke forcuar qëndrueshmërinë e operacioneve teknologjike dhe duke minimizuar ekspozimin ndaj rreziqeve kibernetike.

Si pjesë e përpjekjeve për modernizimin e proceseve dhe avancimin e transformimit digjital, u implementuan zgjidhje dhe funksionalitete të reja që kontribuan në përmirësimin e komunikimit, qasjes në informata dhe efikasitetit operacional.

Përveç projekteve zhvillimore, departamenti ofroi mbështetje të vazhdueshme teknike për stafin dhe rrjetin e degëve, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm të sistemeve dhe adresim të shpejtë të çështjeve të raportuara.



17. BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2025, KEP Trust vazhdoi të investojë në zhvillimin dhe fuqizimin e burimeve njerëzore, me fokus në profesionalizëm, qëndrueshmëri dhe përkushtim ndaj misionit dhe objektivave strategjike.

Në fund të vitit, institucioni numëronte 275 punonjës, duke reflektuar stabilitet organizativ dhe vazhdimësi në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Struktura e stafit mbetet e konsoliduar për të mbështetur operacionet, zgjerimin e aktivitetit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët në të gjithë vendin.

Një tregues i rëndësishëm gjatë vitit ishte niveli i ulët i qarkullimit të stafit, i cili arriti në 5.57%. Ky rezultat pasqyron angazhimin e punonjësve, stabilitetin institucional dhe qasjen afatgjatë në ndërtimin e kulturës organizative dhe ruajtjen e kapitalit njerëzor.

